

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
W INVEST SHPK**

Sot më datë 13/09/2024 :

Shoqëria tregtare SENKA shpk e rregjistruar në QKB me Nipt J94808405Q, në datën 31/05/1994 me adresë në qytetin e Lushnjes, lagja Xhevdet Nepravishta e përfaqësuar ligjërisht nga ortakët e saj **Ylli Senka lindur me 13/01/1963 në Lushnje, atësia Osman, shtetas Shqiptar i identifikuar me ID G30113148O zotërues i 50% te kuotave të saj dhe Donika Senka lindur me 01/11/1960 në Lushnje, atësia Laze, shtetas Shqiptar i identifikuar me ID G06101169I zotërues i 50% te kuotave te saj kemi vendosur:**

Në bazë të ligjit 9901 datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe ligjit 9723 datë 03/05/2007 për QKR, të themeloj shoqërinë tregtare SH.P.K të emërtuar **W INVEST**. Duke nënshkruar këtë Akt Themelimi, aktiviteti i saj do të rregullohet nga statuti i saj i cili do të jetë pjesë përbërëse e këtij akti themelimi.

Neni 1- Emërtimi i Shoqërisë

Shoqëria është person juridik i të drejtës shqipëtare, **SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**. (më poshtë e quajtur “SHOQËRIA”)

Neni 2 - Objekti i Veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë **W INVEST** sh.p.k do të shtrihet në këto fusha veprimi:

Shitje – blerje të ndërtesave për banim ose për aktivitete tregtare. Qiradhënie të ndërtesave. Manaxhim Imobiliar të pasurive të paluajtshme. Ndertimit të të gjitha llojeve, projektim e zbatim, supervizion, rikonstruksione. Studime, konsulence për të gjitha llojet e projekteve dhe punimeve ndërtimore; Veprimtari sipërmarrje për kërkesa investimesh në degë të ndryshme me studime për plota programimi; Prodhimi dhe tregtimi me shumicë e pakice i betoneve dhe materialeve të ndërtimit; Shfrytëzimi industrial i kavove të ndryshme; Aktivitet imobiliare i pasurive të paluajtshme. Import-eksport dhe tregtimi me shumicë e pakice të artikujve të ndryshëm ushqimorë, bujqësorë e blegtoralë, industriale etj. Transport të mallrave e



të udhëtarëve urbane, ndërurbane dhe internacionale, servis Restorante, bilardo, agjenci udhëtimi, turistike, intërnë, shtypshkrime të ndryshme, agjenci komisionere, etj. Aktivitet në fushën e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike të personave juridike shterore apo private ose personave fizike.

Neni 3 – Selia

Shoqëria e ka selinë në Qytetin e Lushnjes, lagja Xhevdet Nepravishta, Bulevardi Kongresi, Ndërtesa 36. Kati 2. H 1.

Përveç veprimtarisë në nivel lokal, shoqëria ka të drejtën e krijimit dhe mbylljes së filialeve, agjencive dhe zyrave të përfaqësimit brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Selia mund të transferohet në çdo vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me një vendim të Ortakëve të kësaj shoqërie.

Shoqëria sipas parashikimeve të këtij statuti dhe legjislacionit në fuqi, mund të hapë si në Shqipëri dhe jashtë saj, qendra, përfaqësi, filiale, degë dhe shoqëri të tjera.

Neni 4- Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së regjistrimit të saj në Rregjistrin e Shoqërive Tregtare pranë Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit. Ky afat mund të ndryshohet një ose më shumë herë, me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 5 – Kapitali Aksionar

Kapitali aksionar do të jetë **1 000 000 (një milion mijë) lekë**. I ndarë në **1 kuotë me vlerë dhe në zotërim si më poshtë :**

1. Senka shpk me NIPT J94808405Q, 1 kuotë me vlerë 1 000 000 (një milion) lekë.

E përfaqësuar nga ortakët e saj themelues Ylli Senka dhe Donika Senka.

Zotërues i vetëm i kësaj kuote është SENKA shpk me NIPT J94808405Q, e shprehur në përqindje 100%

Neni 6- Administrimi

Shoqëria administrohet nga një ose disa administrator, qofshin këta dhe jo ortak, të cilët emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e zakonshme. Administratori/ët qëndrojnë në postin e tyre për pesë vjet financiare, me mundësinë për tu rizgjedhur.

Administratori/ët kanë të gjitha kompetencat për të vepruar në mardhënie me të tretët, në interes të shoqërisë dhe në emër të saj, në të gjitha rrethanat që kanë lidhje me objektin e Shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo statuti ja jep Asamblesë së Ortakëve.

Administrator i shoqërisë është Z. **Ergys Senka** për një afat 5 (pesë) vjecar. Ai do të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme për rregjistrimin e shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit(QKR).

Të gjitha shpenzimet që do të kryen deri në rregjistrimin e shoqërisë si person juridik do të përfshihen në bilancin e shoqërisë.

Neni 7- Ekspertët Kontabël Të Autorizuar.

Shoqëria do të kontrollohet nga një ose disa ekspertë kontabël të autorizuar të zgjedhur nga lista e Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar. Në caktimin e ekspertëve kontabël të autorizuar mbahen parasysh përjashtimet dhe papajtushmëritë e percaktuara nga ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Eksperti/ët kontabël të autorizuar emërohen nga asambleja e përgjithshme, në afatet e parashikuara nga ligji, me të drejtë rizgjedhje në kushtet e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme.

Detyrimet dhe të drejtat e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të shoqërisë janë ato të parashikuara nga ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Raportet që ata përgatisin depozitohen në selinë e shoqërisë, në afatet e parashikuara nga ligji.

Neni 8- Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor.

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Rregjistrin Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Rregjistrimit, dhe perfundon në 31 dhjetor të të njëjtit vit.



Pasqyrat financiare, raporti i administrimit dhe raporti i ekspertit/ve kontabël të autorizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme në kushtet e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme.

Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

Neni 9 - Dispozita te Përgjithëshme

Ky akt themelimi u redaktua në 4 kopje me përmbajtje dhe vlera të njejta juridike në gjuhën shqipe dhe u miratua nen për nen nga aksioneri themelues dhe u nënshkrua në cdo fletë me emër mbiemër dhe nënshkrim me vullnet të lirë.

ORTAKËT THEMELUES

SENKA shpk

Përfaqësuar nga ortakët e saj themelues:

Ylli Senka

Donika Senka



13/09/2024